




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 4354 Prot

Nr. 398 Dosje



Tiranë, më 7.6.2016

URDHËR

PËR VENDOSJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar:

QENDRA KOMBËTARE E RREGJISTRIMIT

TIRANË

Unë Gelas Yzo, me detyrën e Përmbarduesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbardimit Privat **“E.P.S.A” SHPK**, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 6656/U të lëshuar më datë 15.09.2015 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbardimore Nr. 398, Datë 20.05.2016 kërkesën e kreditorit **“Vodafone Albania” SHA** ndaj debitorit **Shoqëria “Alba Telecommunication” SHPK**, në lidhje me titullin ekzekutiv “Vendimi Gjyqësor Nr.6656 date 15.09.2015 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane”.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 3959 Prot, Datë 20.05.2016, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 6656/U të lëshuar më datë 15.09.2015 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitorët e mësipërm, kanë marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorëve në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Në kushtet kur mospërmbushja në referim të nenit 527, 560, 563 të K.Pr.Civile dhe nenit 32 pikat (b,c,ç) të ligjit Nr. 10031, Datë 11.12.2008 “Për Shërbimin Përmbardimor Gjyqësor Privat”,

KËRKOJ

1- Qendra Kombëtare e Rregjistrimit Tiranë, brenda 10-ditësh nga marrja dijani, të kryejë veprimet për **bllokimin e kuotave/aksioneve dhe e të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i kuotave për debitorët**;

- 1) Shoqëria “Alba Telecommunication” SHPK, përfaqësuar nga Z. Besarta Prrenjasi, në cilësinën e Administratorit, me NIPT: L22404014T.

të lartëpërmendur, deri në një urdhër të dytë nga përmbaruesi gjyqësor.

2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen në bazë të nenit 606 të K.Pr.Civile (parag.II)) që parashikon vendosjen e sanksionit të gjobës dhe kallzimin penal.

SHOQËRIA E PËRMBARIMIT PRIVAT “E.P.S.A”SHPK

Përmbaruesi GJYQËSOR

GELAS YZO



A circular blue stamp is located to the right of the signature. The text around the perimeter of the stamp reads: "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top, "SHOQËRIA 'E.P.S.A' SHPK" on the left, "PËRMBARIM" at the bottom, and "GJYQËSOR PRIVAT" on the right. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.